

KËSHILLI I NDERIT pranë Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, SHGM, duke vepruar sipas ankesës së drejtoreshës së SHFK "Karposh" në fshatin Umin Doll - Kumanovë, Tanja Todorovska, kundër gazetarit Furkan Saliu nga PortalX, për prishje të procesit mësimor në shkollë dhe mospublikimin e informacionit që ia kishte dhënë drejtorja e shkollës, në seancën e Këshillit të mbajtur më 30.01.2024 në Shkup, solli këtë

KONKLUZË

PROCEDURA PARA KËSHILLIT TË NDERIT DO TË VAZHDOJË VETËM NËSE SHKOLLA IA DËRGON PORTALIT NË TË CILIN ËSHTË PUBLIKUAR STORJA PRETENDIMET E SHQYRTARA NË ANKESË, NË FORMË TË DEMANTIT, GJË QË NUK ËSHTË BËRË DERI TANI

Arsyetim

Drejtoesha e shkollës në fshatin Umin Doll të Kumanovës, në një ankesë drejtuar Këshillit të Nderit pretendon se gazetari Furkan Saliu dhe ekipi i tij kanë qenë dy herë në shkollë dhe kanë bërë raportim për bullizmin që i është bërë një nxënëseje nga nxënësit e tjerë, duke paraqitur informacione të rreme dhe duke prishur procesin arsimor, dhe këtë e kanë publikuar në portal më 28.12.2023.

Drejtorja e shkollës në parashtresë i kërkon Këshillit të Nderit konstatimin e shkeljes së Kodit të Etikës dhe fshirjen e lajmit nga portali PORTALX.

Pas shqyrtimit të ankesës, shqyrtimit të video-stories së publikuar në portalin e theksuar dhe në një bashkëbisedim me gazetarin Furkan Saliu, Këshilli i Nderit konstatoi se pretendimet në ankesë duhet të jenë në të vërtetë në formë DEMANTI i cili duhet t'i dorëzohet fillimisht gazetarit, d.m.th. portalit në të cilin është publikuar lajmi, dhe pastaj më tej, nëse ka elemente të shkeljes së Kodit, të kërkojë nga Këshilli vazhdimin e procedurës.

Prandaj, Këshilli i Nderit këshillon parashtresën e ankesës, drejtoreshën e shkollës "Karposh" në fshatin Umin Doll, që pretendimet në ankesë t'i kthejë në një Demant, në të cilin do të mohojë informacionet e pasakta ose të transmetuara gabimisht, si dhe t'i përmbahet pretendimit se çfarë provash dhe dokumentesh i janë dhënë gazetarit Saliu, të cilat gjoja nuk i ka publikuar.

Këshilli, pasi shqyrtoi video-storjen në të cilën flet nëna e një nxënëseje ndaj të cilës është ushtruar dhunë nga bashkëmoshatarët në shkollë, nuk gjeti konfirmim për një numër të madh të pretendimeve të bëra dhe për këtë arsye, në këtë fazë të procedurës e ndalon procedurën me këtë KONKLUZË.

Procedura para Këshillit mund të vazhdojë vetëm pas dërgimit të një demanti të qartë që do t'i referohet fakteve dhe informacioneve që pretendohet se nuk janë publikuar ose janë paraqitur gabimisht.

Këshilli i Nderit pranë SHGM-së bën me dije se nuk ka mandat për të tërhequr apo hequr materialet e publikuara në asnjë media dhe në çfarëdo forme, por vetëm për të konstatuar shkelje të standardeve etike në tekstin/raportimin gazetaresk.

Menaxhmenti i shkollës “Karposh” në fshatin Umin Doll, pas marrjes së këtij konkluzioni në e-mailin e përmendur në ankesë, të dërgojë një demant në formën dhe përmbajtjen e përshtuar më sipër dhe vetëm atëherë Këshilli do të marrë një vendim meritore, nëse ka vend dhe kërkesë për ndërhyrje të këtij organi vetërregullues.

Vendosur në Shkup më 30 janar 2024

- Të dorëzohet në shkollën “Karposh”, fshati Umin Doll – kërkuesi, në mënyrë elektronike,
- Të publikohet në faqen e SHGM-së

KËSHILLI I NDERIT NË SHGM

Sashe Dimovski

Kryetar

